

VENDIM
Nr.738, datë 28.5.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA BËRXULL, TË QARKUT TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Bërxull, të qarkut të Tiranës, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 1 (një) fletë, që përfundon me numrin rendor 4 (katër), dhe lidhja nr.1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Bërxull për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FORMULARE PËR TRANSFERIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

(Sipas inventarizimit të pronave të veçanta të tipit: pyje, kullota, livadhe, shkëmbore etj)

Institucioni i pushtetit qendror: MMPAU

		Komuna: Bërxull								
	Nr. rend.	Emërtesa e ekonomise pyjore dhe kullosore (EPK)	Emërtesa e ngastrës vendndodhja (sipas emërteses popullore)	Numri i ngastres	Destinacioni	Sipërfaqja në ha	Funksioni për të cilin perdoret prona	Institucioni, enti me përgjegjësi administrative	Institucioni, enti përdorues statusi juridik liperdorimit	Të dhena te tjera shenime te veçanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	1	Vorë	Pylli Berkullit	40/a	Pyll	5.75	Mbrojtës	M.M.P.A.U	D.Sh.P.	
2	2	Vorë	Përroi i Limuthit	41/b	Pyll	11.72	Prodhues	M.M.P.A.U	D.Sh.P.	
3	3	Vorë	Domje	58/a	Pyll	0.75	Prodhues	M.M.P.A.U	D.Sh.P.	
4	4	Vorë	Domje	58/b	Pyll	1	Prodhues	M.M.P.A.U	D.Sh.P.	

Njësia e qeverisjes vendore: komuna Bërxull

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1	Pyll mbrojtës	Në pronësi
2-4	Pyll prodhues	Në pronësi